

**VENDIM**  
**Nr. 705, datë 29.10.2014**

**PËR HEQJEN E MASËS SË PEZULLIMIT TË VEPRIMTARISË DISA**  
**INSTITUCIONEVE PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 45, pika 4, e 63, pika 4, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Heqjen e masës së pezullimit të veprimtarisë disa institucioneve private të arsimit të lartë:
    - a) Shkolla e Lartë “Instituti Kanadez i Teknologjisë”;
    - b) Universiteti “Aldent”;
    - c) Akademia Profesionale e Biznesit;
    - ç) Shkolla private e arsimit të lartë “Pavarësia”;
    - d) ISSAT;
    - dh) Shkolla e lartë “Wisdom University”.
  2. Institucionet private të arsimit të lartë, të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, të vijojnë veprimtarinë akademike me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ligji për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
  3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet private të arsimit të lartë, të përmendura në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**